Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Anulimit të procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

[Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët, nga operatori ekonomik plotësohet dhe paraqitet vetëm kjo Shtojcë]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlere absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Kujdes: Bazuar në parashikimet e nenit 45/2.1 të VKM Nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, kur si kriter vlerësimi përdoret “oferta ekonomike më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët”, autoriteti kontraktor përllogarit çmimin bazuar në:

- a) çmimin e bursës, së datës kur është publikuar njoftimi i kontratës së procedurës së prokurimit, i konvertuar sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të kësaj date;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës;

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa vlerë do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të çojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	5	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 5.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Hartuar nga Njesia e Prokurimit, e ngritur me Urdhrin nr. 274, date 16.05.2025, te Kryetarit te Bashkise Pogradec, per hartimin e specifikimeve teknike dhe perlogaritjen e fondit limit, per "Sistem Fonia per Sallen e Keshillit Bashkiak", si me poshte:

1. Pajisje qëndrore e Konference

Njesi Kontrolli per sistemin wireless te konferences. Te operoje ne frekuencat 2.4GHz dhe 5GHz. Te kryeje dedektim automatik te interferencave ne salle. Dalje audio per lidhje me Amplifikator mixer etj. (te pakten XLR, RCA dhe Xhek 6.3mm). Te ofroje te pakten 4 modalitete te operimit te konferences, si limitime ne folesa, ne kohe, vetem kryetari etj. Njesia duhet te jete e pajisur me te 2 porta RJ45. Duhet te kete Raport sinjal/zhurme teper te larte dhe vonesa shume te vogla ne transmetim. Pajisja duhet te siguroje nje mbulim te pakten 30m distance. Duhet te jete kompatibel me standardet e wirelessit IEEE802.11 ac etj. Duhet te ofroje teknologjine e enkriptimit dixhital VYPANYPA2 per te siguruar sigurine dhe konfidencialitetin e mbledhjeve.

2. Njësi për drejtuesin me Display, mikrofon.

Mikrofon conference wireless me frekuence 5GHz me funksion Kryetar, Te jete i pajisur me nje koke Condenser per thithje me indikacion Led i cili tregon nese mikrofonit eshte aktiv. Duhet te kete nje ekran OLED jo me te vogel se 2.3" i cili tregon te dhena rreth Gjendjes se Mikrofonit, nivelin e baterise, statusin e wirelessit etj. Mikrofonit duhet te funksionoj me bateri Litium te inkorporuara te rikarikueshme me kapacitet te pakten 10000 mAh. Vonesa maksimale ne pergjigje duhet te jete me e vogel se 20ms, duhet te ofroje kontroll dixhital dhe transmetim me kualitet te larte te audios. Mikrofonit duhet te kete 2 butona, 1 per aktivizim/caktivizim te mikrofonit dhe 1 buton per bllokimin e mikrofonave te tjere.

3. Njesi autonome Wireless per pjesmarresit me mikrofon statik.

Mikrofon conference Wireless me frekuence 5GHZ me funksion Kryetar, Te jete i pajisur me nje koke kondenser per thithje me indikacion Led i cili nese mikrofonit eshte aktiv. Duhet te kete nje ekran OLED jo me te vogel se 2.3" i cili tregon te dhena rreth Gjendjes se Mikrofonit, nivelin e baterise, statusin e wirelessit etj. Mikrofonit duhet te funksionoj me bateri Litium te inkorporuara te rikarikueshme me kapacitet te pakten 10000mAh. Vonesa maksimale ne pergjigje duhet te jete me e vogel se 20ms, duhet te ofroje kontroll dixhital dhe transmetim me kualitet te larte te audios. Mikrofonit duhet te kete 1 buton per aktivizim/caktivizim te mikrofonit.

4. F.V Njësi autonome wireless për pjesmarrësit me 2 mikrofon.

Mikrofon me vale * Mikrofon te frekuences UHF" nje Baze Marrese nje mikrofon dore dhe nje mikrofon Lavalier Minimum te siguroje 400 metra distancë funksionimi* frekuenca të zgjedhshme në 60 deri në 75 MHz. Te pakten 15 grupe ku secili prej deri në 60 kanale të përputhshme* Te funksionoj ne RF pa pengesa me ane te një transmetuesi duke shtypur një buton On. Duhet te kete impedance ne dalje AF: 600 Ohms, Pergjigja ne Frekuence: 50-18kHz me filter. Niveli i daljes Audio: max. 6dBu. Ndjeshmeria: 6dBuV, at S/N> 108dB. Bandwidth: 60~75MHz Wideband(brezgjere). S/N Ratio >108dB (A). T.H.D <0.5% @ IKHz, Mikrofonit

Lavalier dhe I dores duhet tju pershtatet frekuencave UHF 470-960 MHz. Te kene nje Bandwith 60-75MHz. Me qendrueshmeri < +-10KHz dhe devijim te Frekuences +-48K Hz (Kulmi).

5. Router Wireless

Kërkohet një pajisje wireless profesionale për tavan, e përshtatshme për ambiente konferencash me dendësi të lartë përdoruesish. e cila të punojë në dy breza frekuence 2.4GHz dhe 5 GHz dhe të jetë e pajisur me çipa industriale me performancë të lartë. Pajisja duhet të ketë dy porta Gigabit WAN/LAN dhe të ofrojë shpejtësi maksimale deri në 1200 Mbps, mbulim të gjerë dhe të qëndrueshëm wireless me antena omnidireksionale 5dBi dhe përforcues sinjali PA dhe LNA për secilin brez. Duhet të mbështesë analizë të kapacitetit të kanaleve dhe zgjedhje automatike të kanalit optimal për të reduktuar interferencat dhe vonesat. Kërkohet të përputhet me standardin IEEE 802.3at për furnizim përmes PoE me kablllo mbi 100 metra dhe të ketë dizajn për montim në tavan për instalim të lehtë. Pajisja duhet të mbështesë protokollin CAPWAP për menaxhim qendror të rrjetit wireless nëpërmjet platformës WLAN, të ofrojë funksionalitet plug-and-play dhe akses në distancë përmes cloud platformës për kursim të kostove dhe burimeve. Gjithashtu duhet të përfshijë teknologjinë MU-MIMO Wave2 me 4 rryma hapësinore dhe modulim 256-QAM për një transmetim më të shpejtë dhe efikas.

6. Bokse Pasive

Bokse Audio kollone me fuqi te pakten 60Ë RMS. Pergjijga ne Frekuence: [40Hz— 20kHz] Ndjeshmeria: te pakten 110dB. Trup prej alumini kundra kushteve atmosferike. Pesha jo me e madhe se 4kg. Kuti e fortë prej lidhjeje alumini, nuk deformohet dhe nuk ndryshket lehtë. Transformator audio me tela bakri të pastër tip E për të siguruar besnikërinë e daljes audio. E pajisur me kllape montimi shumëfunksionale, instalim i përshtatshëm.

7. Mikser aktiv Rackmaunt

Mikser audio profesional me përpunim digjital dhe funksione të integruara, i përshtatshëm për përdorim në ambiente konferencash, eventesh apo sisteme zëri live, i cili të ketë dizajn qarku me zhurmë ultra të ulët dhe të ofrojë kontroll të detajuar të tingullit për çdo kanal. Çdo kanal duhet të jetë i pajisur me rregullim 3-bandësh të EQ-së (+-15dB për frekuencat HI 12kHz, MID 2.5kHz, dhe LOW 80Hz), buton MUTE, si dhe attenuator rrëshqitës të butë prej 60mm. Mikseri duhet të ketë 1 dalje stereo bus dhe 2 dalje AUX bus (përfshirë efektet FX), si dhe 1 hyrje return dhe 1 dalje RAC për lidhje të jashtme audio. Pajisja duhet të përfshijë furnizim phantom 48V të integruar për mikrofonët kondensator, si dhe 16 efekte digjitale DSP të ndërtuara për përpunim të avancuar të zërit. Duhet të mbështesë luajtjen audio dhe regjistrim përmes USB, të ketë funksion Bluetooth të integruar për pranimin dhe luajtjen e skedarëve MP3, dhe të pajiset me ekran LED për shfaqjen e statusit të luajtjes. Treguesit vizualë të niveleve të audios duhet të përfshijnë indikator 10-segmentësh tre-ngjyrësh për monitorim të saktë të niveleve të zërit.

Specifikimet teknike të domosdoshme përfshijnë:

- Rezponca në frekuencë: 20Hz — 20kHz (+-0.5dB)
- Raporti sinjal/zhurmë (S/N): ≥83dB
- Shtrembërimi harmonik total (THD): <0.02% @0dB, 1kHz

- Interferenca nder-kanale (Crosstalk): <-75dB @1kHz
 - Impedanca hyrëse MIC: 600Ω
 - Impedanca hyrje LINE/Stereo: 10KΩ
 - Impedanca daljeje: 100Ω
 - Niveli maksimal i daljes: 18dB
 - Niveli i hyrjes MIC: -60dB
 - Niveli i hyrjes LINE: -40dB
 - Channel Gain: deri në -30dB
 - Fuqia e daljes: 30W
 - Furnizimi me energji elektrike: 100V-240V / 50Hz, i përshtatshëm për përdorim global.
- Pajisja duhet të jetë fleksibël në përdorim, me konsum të ulët energjie dhe reagim të menjëhershëm pa zhurma të padëshiruara.

8. Amplifikator Audio

Kanale Jo me pak se 2

Fuqi/kanal i vlerësuar: 250W ose me shume per kanal

Tension i vlerësuar i daljes: 70V/100V

Ndjeshmëria e hyrjes: 775mVRMS (0dBV input i balancuar) 100VRMS (input i paekuilibruar 100V)

Raporti S/N: 80dB ose me mirë

Impedanca e hyrjes: 60K ohms (i balancuar), 20K ohms (përparësi), 100K ohms (100V të paekuilibruar)

Reagimi i frekuencës: 80Hz-15kHz (±3dB)

Shtrembërim total harmonik: <0.3% (1kHz)

Konsumi i energjisë: Jo me shume se 1200W

Kërkesa për energji: AC180-260V/50-60Hz DC24V (fuqia e vlerësuar -3dB)

OPSIONE: Prodhimi i energjisë 70V/100V opsional, Plotësisht dixhital, Me funksionin hyrës të përparësisë dhe hyrjen 100V në dispozicion, I montueshëm ne Rack me madhësi jo më shumë se 1U, Me funksion standby për kursimin e energjisë, Me indikacione për fuqi, sinjal, klip, mbrojtje dhe temperaturë.

9. Laptop

Kërkohet një laptop me karakteristika teknike të avancuara për përdorim profesional dhe që plotëson kriteret minimale të mëposhtme:

Karakteristikat Teknike Minimale:

- **Procesor:** Duhet të ketë vlerësim minimal prej 12,000 pikësh sipas faqes zyrtare www.cpubenchmark.net.
- **Memorie RAM:** Minimum 16 GB DDR4-2666 MHz, ECC.

-
- **Hard Disk:** Minimum 256 GB SSD.
 - **Sistemi Operativ:** OEM i parainstaluar Ëindoës Server 2016 (me licencë).
 - **Fuqia elektrike:** 220 V AC, 50 Hz.
 - **Kursimi i energjisë:** Certifikuar me ENERGY STAR.

Komunikimi & Menaxhimi:

- **Portat PCI/PCI-E:** Minimum 4, nga të cilat të paktën 2 PCI-E x16.
- **Portat USB:** Minimum 10 porta USB, të ndara si më poshtë:
 - Minimum 4 USB përpara
 - Minimum 6 USB 3.0
- **Porta të tjera:**
 - (2) porta RJ-45
 - (1) Audio In/Out
 - (1) Microphone
 - (1) Headphone
 - (1) Portë video (mund të përdoret edhe adaptues)
- **Rrjeti:** Dy porta 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet.
- **Zëri:** Kartë zëri e integruar.
- **Altoparlantët:** Të integruar ose të ndërtuar në monitor.
- **Menaxhimi i sigorisë:** Funksione të integruara për menaxhim sigurie.
- **Aksesorë të përfshirë:**
 - Tastierë standarde QËERTY
 - Maus optik me minimum 3 butona dhe scroll
 - Kabëll elektrik në standardin europian
 - Particion për rikuperim (Recovery Partition)

10. Rack 22 U dhe aksesore

Hapësirë 12 Unit për montim në rack.

Përshtatet me pajisjet standarde të montimit në rack

Dizajn i ngurtë kompakt.

Dera mbyllëse e xhamit të mund të instalohet për t'u hapur majtas ose djathtas

Të ketë çelës për dyert

Të ketë hapësira ventilimi në të gjithë vendin për ftohjen e pajisjeve

11. Kabull sinjali Konektor

Kabullo për bokse për furnizim me energji elektrike: të përshtatshëm për furnizim me energji dhe brenda standardeve ndërkombëtare në transmetim;

Përmasat: 2x1.5;

Ngjyrat: kuq dhe zi.

12. Njësi karikimi për mikrofonat wireless

Stacion karikimi për mikrofonat Wireless me të paktën 10 dalje. Mbështet karikimin e shpejtë, daljen e portit USB të karikimit të shpejtë 9V, daljen e karikimit të ngadaltë 5V. Duhet të jetë me një kasë metalike të thjeshtë për instalim dhe operim. Konsumi maksimal i energjisë elektrike të mos jetë më shumë se 200W. Rryma për secilën portë jo më pak se 1Ah.

13. Procesor Dixhital Audio

Procesor dixhital audio, plotësisht automatik dhe inteligjent, i cili të jetë i përshtatshëm për përdorim në sisteme të avancuara konferencash dixhitale, sisteme audio profesionale dhe ambiente të nivelit të lartë për argëtim apo evente. Pajisja duhet të ketë sampling frequency prej 96 kHz, si dhe konvertues A/D dhe D/A me 24-bit, për cilësi të lartë të përpunimit të audios. Një pajisje e vetme duhet të mbështesë ruajtjen e të paktën 20 grupeve të të dhënave të pajisjes dhe 10 grupeve të efekteve, të cilat mund të kopjohen në pajisje të tjera përmes PC-së. Duhet të mbështesë bllokimin e funksioneve për ruajtje të të dhënave, në mënyrë që të parandalohet përdorimi nga persona të paautorizuar. Çdo kanal daljeje duhet të ketë EQ të pavarur me 7 nivele (me parametra të rregullueshëm për frekuenca të larta dhe të ulëta), filtra high-pass dhe low-pass, secili me 1 pjerrësi dhe 3 mënyra të ndryshme funksionimi.

- Kanale hyrëse: të paktën 6
- Kanali hyrës: 5.1/3.1
- Impedanca e hyrjes: të paktën 20 kΩ e pa balancuar
- Impedanca e daljes: të paktën 100Ω e balancuar
- Freq. përgjigje: 20Hz-20kHz (±0.5dB)

- Furnizimi me energji elektrike: AC 220V/110V, 50/60Hz
- Përmasat: Jo më shumë se 482x230x44mm
- Pesha: Jo më shumë se 4.5 kg

Nr.	Pershkrimi i mallrave	Njesia	Sasia	Cmimi pa t.v.sh.	Vlera pa t.v.sh.
A	Preventivi i Fonisë				
1	F.V Pajisje qendrore e Konference	cope	1		
2	F.V Njësi për drejtuesin me Display, mikrofon.	cope	1		
3	F.V Njësi autonome wireless për pjesmarrësit me 2 mikrofon.	set	1		
4	F.V Njësi autonome wireless per pjesmarresit me mikrofon statik.	cope	32		
5	Router Wireless	cope	1		
6	F.V Bokse Pasive	cope	3		
7	F.V Mikser aktiv Rackmaunt	Set	1		
8	Amplifikator Audio	cope	1		
9	Laptop	cope	1		
10	Rack 22 U dhe aksesore	cope	1		
11	Kabull sinjali Konektor	cope	1		
12	Njesi Karikimi per mikrofona wireless	Cope	2		
13	Procesor Dixhital Audio	Cope	1		
A	Totali Preventivi i Fonisë				
	T.v.sh. 20%				
	Totali				

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**Sasia e mallit që kërkohet:**

Nr.	Pershkrimi i mallrave	Njesia	Sasia	Cmimi pa t.v.sh.	Vlera pa t.v.sh.
A	Preventivi i Fonisë				
1	F.V Pajisje qendrore Konference	cope	1		
2	F.V Njësi për drejtuesin me Display, mikrofon.	cope	1		
3	F.V Njësi autonome ëireless për pjesmarrësit me 2 mikrofon.	set	1		
4	F.V Njesi autonome wireless per pjesmarresit me mikrofon statik.	cope	32		
5	Router Wireless	cope	1		
6	F.V Bokse Pasive	cope	3		
7	F.V Mikser aktiv Rackmaunt	set	1		
8	Amplifikator Audio	cope	1		
9	Laptop	cope	1		
10	Rack 22 U dhe aksesore	cope	1		
11	Kabull sinjali Konektor	cope	1		

12	Njesi Karikimi per mikrofona wireless	cope	2		
13	Procesor Dixhital Audio	cope	1		
A	Totali Preventivi i Fonisë				
	T.v.sh. 20%				
	Totali				

Afatet e lëvrimit: 15 ditë nga e nesërmja nënshkrimit të kontratës

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

Shtojca 8.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit ,**sipas Shtojcës 9.**

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore financiare të 3 (tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e furnizim -vendosjes së objektit të kontratës, duhet të disponojë personelin kryesor:

- 1 (një) inxhinier Elektronik si dhe 2(dy) Specialiste Informatike.

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

-diploma përkatëse.

-kontrata e punës e vlefshme

-si dhe të figurojë në Listëpagesa të paktën për muajin e fundit të deklaruar nga hapja e ofertave

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te jete i pajisur me Çertifikatat:

- Çertifikatë ISO 9001 e “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” të vlefshme
- Çertifikatë ISO 27001 e “Sistemit Menaxherial të Sigurisë së Informacionit”

Çertifikata e mësipërme të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre, të lëshuara nga një Organ i Vlerësimit të Konformitetit, i akredituar nga Organizmi Kombëtar i Akreditimit ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostrat (kampionët) në orën dhe ditën e hapjes së ofertave prane Bashkisë Pogradec ,te mbyllura ne kuti, mbi te cilat te shenohet: “MOS E HAPNI ME PERJASHTIM TE RASTEVE KUR ESHTË I PRANISHEM KOMISIONI I HAPJES DHE VLERESIMIT TE OFERTAVE DHE JO PERPARA DATES DHE ORES SE HAPJES SE OFERTAVE”. Mostrat te shoqerohen me nje liste ku te shenohen produktet qe ndodhen ne kuti dhe te kete jo më pak se 1 (një) kampion:

- 1 (një) njësi Kontrolli për sistemin e konferencës Wireless
- 1 (një) Mikrofon Konference me Wireless Kryetar
- 1 (një) Mikrofon Konference me Wireless Delegat

2.3.5 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet të paraqesë **autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori**, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi.

Për rastin kur autorizimi do të jetë lëshuar nga distributori i autorizuar, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin(kontratë/autorizim)që vërteton lidhjet e firmës prodhuese me distributorin

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.6 Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogje** për artikujt e procedurës, ne te cilet te specifikohen produktet e kerkuara.

2.3.7 Operatoret ekonomike ofertues duhet te paraqesin mallra te certifikuara dhe qe permbushin standartet Europiane, sipas normativave CE, e vertetuar kjo me paraqitjen e deklarates se konformitetit (e perkthyer dhe e noterizuar).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)***FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
 _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër⁶.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

⁶ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi

për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005). Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.
